



Pranimat / Dorezuar Punjenet/Prodato Received/Delivered	19.02.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	734/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.16/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ilirë Mehmeti Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.16/2021 të datës 15.01.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi rruga "Xhemajl Ymeri" Nr.14, 60 000 Gjilan, kundër organit të punësimit Shërbimi Sprovues i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 19.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.16/2021 e datës 15.01.2021 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ Zyrtar Sprovues pran Shërbimit Sprovues të Kosovës, me datë 15.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 159/2021 të regjistruar me numër A.nr.16/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që t'i njihet e drejta e kompensimit të pagesës në emër të rrezikshmërisë në punë si Zyrtar Sprovues, për periudhën 18.04.2019 - 29.02.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 18.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Sprovues i Kosovës. Këshilli me datë 20.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 159/2021 të datës 15.01.2021 të regjistruar me numër A.nr.16/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emalin e datës 23.12.2020; Kërkesën e datës 23.12.2020; Emalin e datës 24.12.2020; Emalin e datës 05.01.2021; Vendimin e datës 18.04.2019 me numër të protokollit 42/7 lidhur me transferimin e nëpunësit civil; Akt Emërimit të datës 18.04.2019; Marrëveshjen e datës 17.04.2019; Emalin e datës 08.02.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 168/2021 të datës 18.01.2021; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 226/2021 të datës 20.01.2021; Listën e pagave për muajin mars të vitit 2020; Listën e pagave për muajin prill të vitit 2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar,*
sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Marrëveshjen për transferimin e nëpunësit civil, të datës 17.04.2019 të lidhur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita e punës Zyrtar për Pranim dhe Lirim pran Qendrës së Paraburgimit në Gjilan - Shërbimi Korrektues i Kosovës, në pozitën e punës Zyrtar Sprovues pran Zyrës Rajonale në Gjilan - Shërbimi Sprovues i Kosovës. Sipas kësaj marrëveshje, ankuesi është transferuar se bashku me buxhetin dhe pozitën, nga data 18.04.2019. Sipas provave të dërguara nga organi i punësimit ankuesi nga data 18.04.2019 deri me datë 01.03.2020 është paguar nga buxheti i Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe i njëjti përveç pagës bazë ka realizuar edhe shtesën në pagë në emër të rrezikshmërisë në punë, në vlerë prej 35 euro në muaj, ndërsa nga data 01.03.2020 ankuesi ka kaluar në listën e pagave të Shërbimit Sprovues të Kosovës, i cili përveç pagës bazë realizon edhe shtesën në pagë në vlerë prej 107 euro në muaj.

Ankuesi me datë 23.12.2020 i është drejtuar Menaxherit të Personelit në Shërbimin Sprovues të Kosovës, me kërkesë që t'i njihet e drejta e kompensimit të rrezikshmërisë në punë në mënyrë retroaktive nga data 18.04.2019 deri me datë 01.03.2020, sipas Udhëzimit Administrativ MDNR.08/2013 për Kategorizimin e Rrezikshmërisë në Punë për Personelin e Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Menaxheri i Personelit në Shërbimin Sprovues të Kosovës, me datë 24.10.2020 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se ankuesi nga data 18.04.2019 deri me date 01.03.2020, sipas marrëveshjes mbi transferimin e nëpunësit civil ka qenë duke realizuar pagën dhe shtesën për rrezikshmëri nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa nga data 01.03.2020 ankuesi ka kaluar në listën e pagave të Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe i njëjti realizon pagën bazë dhe shtesën për rrezikshmëri sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR.08/2013 për Kategorizimin e Rrezikshmërisë në Punë.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 24.10.2020 të Menaxheri të Personelit të Shërbimit Sprovues të Kosovës, ankuesi me datë 15.01.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: mos zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; mos zbatimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD-NR.08/2013 për Kategorizimin e Rrezikshmërisë në Punë për personelin e Shërbimit Sprovues të Kosovës; dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike.



Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës të dërguar nga organi i punësimit ka konstatuar se ankuesi nga data 18.04.2019 kur është transferuar në Shërbimin Sprovues të Kosovës, deri me datë 29.02.2020 ka realizuar pagën bazë dhe shtesën për rrezikshmëri në punë, në vlerë prej 35 euro nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, sipas Marrëveshjes për Transferimin e Nëpunësit Civil të datës 17.04.2019 ku parashihet se transferimi i nëpunësit civil bëhet se bashku me buxhetin dhe pozitën nga SHKK në SHSK. Ndërsa nga data 01.03.2020 ankuesi ka kaluar në listën e pagave të Shërbimit Sprovues të Kosovës, ku përveç pagës bazë realizon edhe shtesën për rrezikshmëri në punë, në vlerë prej 107 euro në muaj, sipas Udhëzimit Administrativ MD-NR.08/2013 për Kategorizimin e Rrezikshmërisë në Punë për personelin e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Andaj duke marr parasysh se ankuesi ka pranuar të transferohet me këto kushte dhe meqenëse deri me datë 01.03.2020 ankuesi është paguar nga lista e pagave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe përveç pagës bazë ka realizuar edhe shtesën e rrezikshmërisë sipas rregullatives ligjore të Shërbimit Korrektues, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin në mënyrë retroaktive të shtesës së rrezikshmërisë të Zyrtarit Sprovues për periudhën 18.04.2019 – 29.02.2020 është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.16/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Sprovues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPM SHCK-së.

